

 KOLEGJI UNIVERSITAR <b>BEDËR</b>	<b>PROCEDURA E PRANIMIT TË STUDENTËVE TË HUAJ</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	<i>BU-PRC-014-AL</i>	01.10.2012	-	-	1 / 1

Studentët e huaj për tu pranuar në Kolegjin Universitar "Bedër" në programet e zgjedhura nga ana e tyre duhet të ndjekin hapat e mëposhtëm:

**Hapi I:** Studentët e huaj duhet të paraqesin dëshmi të gjuhës së programit të zgjedhur nga ana e tyre. Për studentët që janë folës amëtarë të gjuhës së programit nuk është e nevojshme paraqitja e një dëshmie të tillë.

**Hapi II:** Studentët e huaj që posedojnë dëshmi të njohjes së gjuhës së programit në nivelin e kërkuar ose janë folës amëtarë të gjuhës së programit duhet të aplikojnë në Sektorin e Njohjes së Diplomave pranë MAS për ekuivalentimin e diplomës.

**Hapi III:** Studentët e huaj që nuk posedojnë dëshmi të njohjes së gjuhës së programit në nivelin e kërkuar janë të detyruar të regjistrohen në një qendër kursesh të gjuhëve të huaja për të arritur nivelin e kërkuar të gjuhës së programit që kërkohet nga Kolegji Universitar "Bedër". Nëpërmjet regjistrimit në qendrën e kurseve të gjuhëve të huaja duhet të aplikojnë për marrjen e vizës dhe lejes së qëndrimit.

**Hapi IV:** Studentët e huaj pasi të arrijnë nivelin e kërkuar të gjuhës së programit duhet të aplikojnë në Sektorin e Njohjes së Diplomave pranë MAS për ekuivalentimin e diplomës.

**Hapi V:** Studentët e huaj që paraqesin dëshmi të njohjes së gjuhës së programit në nivelin e kërkuar, diplomën e ekuivalentuar dhe dokumentet e tjera të kërkuara kanë të drejtë të regjistrohen në programet e zgjedhura nga ana e tyre.

Verifikimi i dokumentacionit bëhet nga Zyra e Sekretarisë Mësimore.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e sekretarisë mësimore	Këshilli i sigurimit të cilësisë	Senati